

Prishtinë, 14.01.2008
Kodi i ZRRE-së: D_077_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji duke u bazuar në:

1. Nenet 15.2 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenet 16 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
Kërkesën zyrtare nga Sistemi i Transmisionit të Kosovës dhe Operatorit të Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 18 dhjetor 2007, **në seancën e mbajtur me 14 janar 2008 ka nxjerrë këtë:**

VENDIM

I. MIRATOHEN Indikatorët Teknik të Performances të Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka shqyrtuar, plotësuar dhe miratuar Planin Zhvillimor të bashkangjitur kërkesave të KOSTT-it.
2. Indikatorët Teknik të Performances do të publikohen nga KOSTT SH.A brenda 5 ditë pune, pas njoftimit nga ZRRE-ja apo pas publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
4. Pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e pranimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bashkangjitur: **Versioni i aprovuar i Indikatorëve Teknik të Performances të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, KOSTT SH.A.**

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Naim Bejtullahu, Anëtar

Nysret Avdiu, Anëtar